



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rr. Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 488/004
Dt 26.03.2019

Në bazë të nenit 48, pika 1.3, të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 19.3.2019, mori:

VENDIM

- I. Refuzohet si e pabazë ankesa e Vesel Islamit me nr. 1573 të datës 06.11.2018, e paraqitur kundër vendimit të Senatit për përzgjedhjen e personelit akademik në bazë të konkursit plotësues të shpallur më 13.09.2018 të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".
- II. Vërtetohet në tërësi raporti i Fakultetit të Edukimit, për përzgjedhjen e Kadri Mehmetit në pozitën: Një asistent për lëndët: Metodologji e leximit letrar, Histori e Letërsisë Kombëtare, Letërsi për fëmijë, Metodologji e leximit letrar.

Arsyetim

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs plotësues për zgjedhjen e Një asistent për lëndët: Metodologji e leximit letrar, Histori e Letërsisë Kombëtare, Letërsi për fëmijë, Metodologji e leximit letrar në Fakultetin e Edukimit.

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 19.3.2019, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit për ankesa dhe parashtresa, u pajtua plotësisht me propozimin e Komisionit vlerësues, sepse kandidati i përzgjedhur i ka plotësuar të gjitha kriteret për përzgjedhje. Ndërsa, ankimesi ka moshë më të vjetër sesa 30 vjet, si dhe kriteri për përvojë pune vjen në shprehje kur ka kandidatë me kushte të barabarta. Në bazë të kësaj që u tha më sipër, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, MASHT-it.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Fakultetit;
4. Zyrtarit ligjor.



Prof. dr. Alush Musaj

Kryesues i Senatit